



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE LUSHNJE

Nr.385 Regj

Lushnje, më 25.05.2022

VENDIM –SHPALLJE

(Lidhur me ekzekutimin e “Urdhërit të Ekzekutimit” të titullit ekzekutiv të debitorit)

Në Lushnje, sot më datë 25.05.2022,

Unë Brikena Luto, me detyrë Përmbarues Gjyqësor pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje, pasi studiova aktet proceduriale të çështjes përmbarimore nr.385, datë 16.05.2022 bazuar në urdhërin e ekzekutimit nr.352 të lëshuar në datë 10.01.2022 nga Prokuroria pranë Gjykata së Shkallës së Parë Lushnje,

K O N S T A T O V A :

Se në datë 16.05.2022 është depozituar pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje kërkesa e kreditorit Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje së bashku me urdhërin e ekzekutimit nr.352, datë 10.01.2022 lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykata e Shkallës së Parë Lushnje për vendimin nr. 251, datë 09.11.2021 të Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje me palë:

- Kreditor: Buxheti i Shtetit
- Debitor : Selami Murat Kasapi
- Me objekt:Shpenzime proceduriale në shumën 64 512 lekë

Nga ana e Zyrës së Përmbarimit Lushnje ka filluar procedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr. Civile si dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “ *Për Organizimin dhe Funksonimin e Shërbimit Përmbor Gjyqësor*”, i ndryshuar, për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të sipërcituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se debitori Justit Aristir Maka nuk ka marr dijeni nëpërmjet shërbimit postar, si rezultat i kësaj bazuar në nenet 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe neni 517 të Kodit të Procedurës Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike e debitorit lidhur me detyrimin që ka ai ndaj palës kreditore buxhtetit të shtetit për shpenzimet proceduriale në vlerën 64 512 lekë.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 133/a, 133/b, dhe 144/a si dhe 517 të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr.8730, datë 18.01.2001 “ *Për Organizimin dhe Funksonimin e Shërbimit Përmbor Gjyqësor*”, i ndryshuar.

V E N D O S A :

1. Të kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditor (duke marr parasysh edhe komunimin postar), nga data 26.05.2022 – 14.06.2022 të debitorit Selami Murat Kasapi;
2. Ky vendim përpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në këndin e njoftimit të Zyrës së Përmbarimit Lushnje, një kopje dërgohet për afishim pranë në këndin e publikimeve të Bashkisë Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe një kopje dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Tiranë.

3. Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Selami Murat Kasapi, me banim në rrugën "Kongresi", Nd.46, H.18, Ap.13, Lushnje
4. Pala debitore Selami Murat Kasapi, me banim në rrugën "Kongresi", Nd.46, H.18, Ap.13, Lushnje të paraqitet pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje në lagjen "Çlirim", kati i parë, hyrja mbarapa në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe të marr kontaktet me përmbaruesin gjyqësor të çështjes përmbarimore për t'iu vënë në dispozicion aktet e dosjes përmbarimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutim detyruar sipas nenit 519 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile.

U shpall në Lushnje, sot më datë 25.05.2022

PËRMBARUES GJYQËSOR
Brikena Luto

